

2452

71/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SHËRBIMI I INFORMACIONIT DHE DOKUMENTACIONIT  
SHERBIMI I KOMUNIKIMIT  
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1562 prot.

Tiranë, më 22.04.2024

Lënda: Kthim përgjigje

**Z. DORIAN MATLIJA** ✓  
**QENDRA "RES PUBLICA"**  
Blv. "Gjergj Fishta"; Nd.24; H.3; Ap.7; Tiranë


Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në datën 18.04.2024 dhe në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në të cilën kërkonti kopje të relacionit shoqërues të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë", po ju dërgojmë bashkëlidhur këtë dokumentacion, duke përmbushur detyrimin ligjor për dhënie informacioni.

Falënderit për mirëkuptimin!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
Këshilli i Ministrave

Tiranë, më 3.2.94.

-----  
Nr. 271

L e n d a : Dërgim projektligji.

KUVENDIT POPULLOR

T I R A N Ë

Bashkëlidhur keni projektligjin "Për noterinë",  
së bashku me relacionin përkatës.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

ALEKSANDËR MEKSI



KUVENDI  
ARKIVA  
VËRTETOHET NJËSIA  
ME ORIGJINALIN

## RELACION

PËR

### PROJEKTLIGJIN PËR NOTERINË

Noteria, si një veprimtari juridike në shërbim të personave fizikë e juridikë, është mjet për sigurimin e të drejtave pasurore e personale të tyre.

Rregullimi juridik i noterisë ndihmon për zhvillimin e veprimtarisë private mbi bazën e një disponimi të lirë të pronësisë private dhe të zhvillimit të marrëdhënieve kontraktore në një treg të lirë. Projektligji që paraqitet për shqyrtim, plotëson një boshllëk të legjislacionit të trashëguar nga shteti totalitar komunist.

Në pjesën e parë të projektligjit, "Organizimi i noterisë", në nenin 1 bëhet fjalë për përmbajtjen e veprimtarisë noteriale dhe për qëllimin e saj. Noteri është i lirë në profesionin e tij, vepron privatisht dhe i nënshtrohet vetëm ligjit, por funksioni i tij ka karakter të veçantë që siguron garancinë për vërtetësinë dhe, kur është rasti, edhe fuqinë ekzekutive të akteve dhe të veprimeve noteriale që kryejnë personat fizikë e juridikë. Është për këtë arsye që noteri, si veprimtar publik, barazohet me nëpunësin publik dhe mbrohet nga ligji. Shteti vë norma që sigurojnë e garantojnë këtë natyrë të veprimtarisë noteriale, pa prekur veprimtarinë e lirë të tij. Duke u nisur nga ky fakt, në nenin 2 të projektit parashikohen kërkesat për ushtrimin e profesionit të noterit, të cilat mendojmë se sigurojnë një specializim të veçantë dhe garancitë morale për ushtrimin e këtij profesioni.

Për këtë qëllim është parë e nevojshme kryerja e një stazhi njëvjeçar dhe e provimit të kualifikimit. Duke marrë parasysh përvojën që fiton juristi që ka punuar si gjyqtar a avokat, ose në ish-zyrat e ndihmës juridike, si dhe në përgatitjen profesionale të gjithanshme që





duhet të ketë një pedagog i Fakultetit të Drejtësisë, është menduar që këta persona të përjashtohen nga detyrimi për të kryer stazhin.

Ministria e Drejtësisë ushtron kontrollin vetëm mbi veprimtari ligjore të noterëve dhe mban regjistrin e zyrave noteriale. Sipas nenit 6 të projektligjit, ministri i Drejtësisë emëron e largon nga detyra noterët, pasi ka marrë edhe mendimin e Këshillit Kombëtar të Noterisë. Atij i lihet kompetencë të organizojë e rregullojë funksionimin, mënyrën dhe lëndët, për të cilat do të jepet provimi i kualifikimit për juristët që dëshirojnë ta ushtrojnë këtë profesion.

Në këtë kapitull të pjesës së parë sanksionohet se detyra e noterit nuk mund të pajtohet me qenien e tij si gjyqtar, prokuror, hetues, avokat ose të kryejë veprimtari tjetër publike e private, përveç asaj shkencore e mësimdhënëse. Noteri ka zyrën e tij dhe vulën personale. Në veprimtarinë noteriale përdoret gjuha shqipe dhe, kur kërkuesi nuk e di atë, ose aktet noteriale kërkohen të hartohen në gjuhë të huaj, përdoret përkthyesi.

Një aspekt me rëndësi në këtë kapitull është e drejta e noterit të ankohet në gjykatën e rrethit, ku e ushtron veprimtarinë e vet, për largimin e tij nga detyra ose për masat disiplinore të marra ndaj tij nga dhoma e noterëve.

Në kreun e dytë bëhet fjalë për të drejtat dhe detyrat e noterit, tërësia e të cilave synon realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizikë e juridikë.

Financimi i veprimtarisë noteriale është objekti i kreut të tretë të pjesës së parë të këtij projekti, në të cilin përcaktohet se tarifat për kryerjen e akteve e të veprimeve noteriale caktohen nga Ministria e Drejtësisë, duke marrë edhe mendimin e Ministrisë së





Financave. Burimi i financimit janë të ardhurat që vjel noteri nga kjo veprimtari, nga e cila, pasi të zbriten taksat dhe detyrimet e tjera ligjore, diferenca shkon në pronësi të noterit. Është parashikuar edhe mundësia e kryerjes falas të akteve e të veprimeve noteriale, kur personi fizik nuk ka mundësi t'i përballojë vetë tërësisht ose pjesërisht shpenzimet.

Organizimi i përfaqësimit profesional të noterëve trajtohet në një kapitull të veçantë. Noterët krijojnë "Dhomat e noterëve", mbi bazën e një ose të disa rretheve. Projekti parashikon përbërjen dhe kompetencat e mbledhjes së përgjithshme të noterëve, si organi më i lartë i dhomës, si dhe të "Këshillit të dhomës së noterëve" si organ drejtues. Dhoma Kombëtare e Noterëve dhe Këshilli Kombëtar i saj janë organe që zgjidhen nga mbledhja e përgjithshme e dhomave të noterëve të Republikës, sipas normave të përfaqësimit të caktuara në statut. Megjithëse janë organe qendrore, kompetencat e tyre janë të tilla që ruajnë pavarësinë e dhomave të noterëve në rrethe.

Pjesa e dytë e projektligjit rregullon zhvillimin e veprimtarisë të zyrave noteriale, duke përcaktuar kompetencat e noterëve, rregullat e përgjithshme për hartimin e akteve noteriale, si dhe veprimet konkrete për hartimin e çdo lloji akti ose kryerjen e veprimit noterial.

Personave juridikë e fizikë u është siguruar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës për çdo veprim të padrejtë e të paligjshëm të kryer nga noteri.

Gjithashtu noteri nuk mund të kryejë akte noteriale, në të cilat merr pjesë ose janë të interesuar aivëtë, bashkëshortja, fëmijët dhe të afërmit deri në shkallë të tretë, të birësuarit prej tij, krushqia e afërt, ose personi ndaj të cilit ai është emëruar kujdestar.





Është parashikuar ruajtja e të dhënave që përbëjnë sekret profesional, paprekehmëria e akteve noteriale të mbajtura prej tij, përveç rasteve kur kërkohen nga gjykata a prokurori, kur ka filluar një çështje penale që ka lidhje me to. Por në çdo rast aktet e vullnetit të fundit, siç është testamenti, nuk mund të preken para vdekjes së testatorit, përveç rasteve kur ai e kërkon vetë ose përfaqësuesi i tij i pajisur me prokurë të posaçme. Në projekt parashikohen edhe një sërë garancish të tjera për realizimin e të drejtave të shtetasve ose të personave juridikë, siç janë pranimi për ruajtje e dokumenteve, lëshimi i kopjeve të dokumenteve, vërtetimi se ato janë autentike, hartimi i kontratave noteriale etj.

Projektligji ngarkon ministrin e Drejtësisë të nxjerrë udhëzime të veçantë për evidencimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale dhe për organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale.

Projektligji u është dërguar për mendime Gjykatës së Kasacionit Prokurorisë së Përgjithshme, disa gjykatave të rrethit, gjykatave të apelit dhe Fakultetit të Drejtësisë.

Projekti përfundimtar u është dërguar edhe specialistëve përkatës të ngarkuar nga Drejtorja e çështjeve juridike të Këshillit të Evropës dhe Bashkimi Ndërkombëtar të Notariatit Latin, të cilët e kanë vlerësuar dhe kanë dhënë ndihmesë në përmirësimin e mëtejshëm të tij.

Projektligji "Për noterinë" që paraqitet për shqyrtim, do të jetë pjesë e një legjislacioni të ri në një demokraci moderne, në kuadrin e një shteti të ri të së drejtës.

KËSHILLI I MINISTRAVE

